



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional (MPN) më datë 27 prill të vitit 2017 realizoi vizitë të rregullt të paparalajmëruar në Institucionin Ndëshkues-Korrektues Burgu Shkup (pjesa e paraburgimit), në kuadër të mandatit dhe kompetencave të cilat burojnë nga Protokollin Fakultativ ndaj Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese dhe Ndëshkuese dhe Ligji i Avokatit të Popullit.

Vizita u realizua në bashkëpunim me bashkëpunëtorët e jashtëm – përfaqësues të Shoqatës të Psikiatërve të RM-së dhe Shoqatës për Mjekësi Ligjore pranë Shoqatës për Mjekësi Ligjore, në bazë të nënshkrimit paraprak të Memorandumit për Bashkëpunim. Gjithashtu, gjatë kohës së vizitës, Ekipi i MPN-së u shoqërua nga anëtarët e Nënkomitetit për Parandalimin e Torturës të Kombeve të Bashkuara.

Në Burgun Shkup, Reparti i paraburgimit disponon me kapacitet prej 310 personave të paraburgosur, ndërsa në momentin e vizitës ishin vendosur 182 persona të paraburgosur, nga të cilët numri më i madh i personave ishin të gjinisë mashkullore, ndërsa vetëm 2 ishin të gjinisë femërore dhe 1 i mitur. Ekipi i MPN-së realizoi këqyrje në numrin më të madh të pjesëve (krahëve) të Repartit të paraburgimit në Burgun Shkup, me qëllim që të përcaktohen kushtet materiale në të cilat janë vendosur personat e paraburgosur. Njëherësh, u zhvilluan biseda kolektive dhe individuale me disa persona të paraburgosur sipas zgjedhjes së rastit, me qëllim që të përcaktohet nëse personave u respektohen të drejtat të cilat u takojnë, konform Ligjit për Procedurë Penale dhe Rregullores për rendin e shtëpisë për kryerjen e masës së paraburgimit.

Gjatë rrjedhës së vizitës u konstatua se në hapësirën e njëjtë vendosen persona të paraburgosur të gjinive të ndryshme dhe persona të cilët akuzohen si bashkëpjesëmarrës të veprës së kryer penale. Për çdo person të paraburgosur ishte siguruar krevat i veçantë, megjithatë, një pjesë e madhe e dyshekëve dhe krevateve ishin të vjetër, ndërsa disa ishin të grisur dhe të papastër. Pjesa më e madhe e personave të paraburgosur shtrojnë e sigurojnë vet dhe e njëjta lahet një herë në javë. Në ditën e vizitës, ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional vuri re se më shumë krevate kishin çarçafë të papastër-shtrojë të ndotur.

Gjatë vizitës, Ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional, në të gjitha hapësirat konstatoi shkallë të lartë të lagështisë dhe mykut nëpër mure, veçanërisht në pjesën rreth dritareve. Fakti se shiu pikon edhe në hapësirat në të cilat janë ndërruar dritaret e reja me dritare tjera relativisht të reja, vë në dukje se instalimi i këtyre dritareve nuk është bërë në mënyrë përkatëse.

Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi se niveli i lartë i lagështisë, thuaja se në të gjitha hapësirat e vizituara, është problem serioz, i cili drejtpërsëdrejti ndikon mbi përkeqësimin e gjendjes shëndetësore të personave të paraburgosur, ndërsa si pasojë e gjendjes së këtillë, disa persona të paraburgosur i potencuan dhimbjet e vazhdueshme të kokës dhe frymëmarrjen e vështirësuar. Përkatësisht, në shumicën e hapësirave lagështia relative ishte mbi kufirin e epërm prej 60RH dhe lëvizte rreth 68-70RH.

Në asnjërën nga hapësirat e vizituara, në të cilat janë vendosur personat e vendosur nuk kishte sistem funksional për thirrjen e personave zyrtarë, kështu që thirrja, përkatësisht vendosja e kontaktit midis personave të paraburgosur dhe personave zyrtarë, bëhet përmes thirrjes dhe trokitjes në derë. Megjithatë, shpeshherë ndodh që personat zyrtarë të Sektorit për sigurim të mos i dëgjojnë thirrjet e tyre, veçanërisht nëse ata gjenden në anën e kundërt të korridorit në të cilin gjendet hapësira konkrete. Kjo paraqet problem serioz në rastet kur nevojitet intervenimi urgjent nga ana e personave zyrtarë.

Mekanizmi Parandalues Nacional tanimë disa vjet me radhë konstaton se në Burg nuk ekziston trapezaria, ku në mënyrë përkatëse personat e paraburgosur do ta konsumonin ushqimin në mënyrë adekuate, por këtë e bëjnë në hapësirat në të cilat janë qëndrojnë.

Gjithashtu, shqetëson fakti se kushtet materiale në hapësirën në të cilën ishte vendosur personi i mitur ishte në gjendje tejet të keqe. Po ashtu, hapësira ishte pajisur me dy krevate të vjetër, dy dollapë prej metali dhe një tavolinë gjysmë-e thyer, ndërsa të gjitha muret ishin me lagështirë dhe myk.

Në përputhje me nenin 176 të Ligjit për procedurë penale, “gjatë vuajtjes së masës paraburgim nuk guxon të ofendohet personi ose dinjiteti i të akuzuarit”. Ky parim parashikohet edhe në të Drejtat Standarde Minimale për trajtimin e të burgosurve, të cilët parashikojnë se duhet të zbatohen pa diskriminim në bazë të: racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, gjuhës, religjionit, mendimit politik ose mendimit tjetër, prejardhjes nacionale ose sociale, pronës, lindjes ose statusit tjetër.

Nga bisedat e zhvilluara me personat e paraburgosur, Ekipi i Mekanizmi Parandalues Nacional u informua se shpeshherë ka ndodhur që personat e paraburgosur të ofendohen në bazë nacionale dhe veçanërisht ata të nacionalitetit rom. Për një pjesë të personave zyrtarë, të paraburgosurit theksuan se sillen me arrogancë, përkatësisht në komunikim me personat e paraburgosur drejtohen me ton të lartë me dhe përçmim. Megjithatë, asnjë nga të personat e paraburgosur, me të cilët u bisedua, nuk u ankua për ndonjë keqtrajtim fizik.

Nga bisedat e zhvilluara Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi se kontrollet personale ndaj personave të paraburgosur i kryejnë personat zyrtarë të gjinisë së njëjtë, por jo çdoherë, gjatë kohës së kontrollit, janë të pranishëm nga dy persona zyrtarë. Një pjesë e personave të dënuar theksuan se kontrollet kryen në hapësirën e (kujdestarit të turnit), ku të njëjtët u nënshtrohen vështirimeve edhe të personave të tjerë zyrtarë, ndërkaq veçanërisht shqetësojnë informacionet se disa nga personat zyrtarë, gjatë kohës së kontrolleve, janë sjell në mënyrë “të ashpër, arrogante dhe përçmuese”. Në këtë kontekst, Mekanizmi Parandalues Nacional sugjeroi se kontrollet, në asnjë rast, të mos kryhen në hapësirat në të cilat personat u nënshtrohen vështirimit të personave të tretë dhe të njëjtit të bëhen me respektim të plotë të dinjitetit njerëzor dhe privatësisë së personit të paraburgosur, në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë.

Si rezultati i vizitës së realizuar, Mekanizmi Parandalues Nacional përpiloi raport të posaçëm, në të cilin i konstatoi gjendjet dhe dha rekomandime përkatëse të cilat ia dërgoi Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe drejtorit të Burgut, me qëllim të eliminimit të rreziqeve dhe mangësive.